

Kur mund të telefonoj në 112?

Numri unik i emergjencës **112** është për rastet kur keni nevojë për ndihmë urgjente, për shembull kur jeta juaj është në rrezik të menjëhershëm, nëse dikush është plagosur rëndë dhe ka nevojë për kujdes të shpejtë mjekësor, nëse keni qenë dëshmitar i një krimi të rëndë si sulm, vrasje, grabitje ose një thyerje, i një aksidenti etj.

Cilin shërbim kërkon?

Kur të telefononi 112, ju lutemi tregojini Operatorit:

- çfarë ka ndodhur;
- çfarë ndihme është e nevojshme;
- çfarë shërbimi urgjence mendoni se kërkohet: **Policia e Shtetit, Zjarrfikësja ose Urgjenca Mjekësore.**

Operatori i urgjencës do të dërgojë drejtpërdrejt shërbimin e duhur të urgjencës në zonën tuaj.

